



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.77

2 korrik

2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Rezolutë e Kuvendit datë 10.6.2010	Për raportin e prokurorit të përgjithshëm “Mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2009”	4037
Vendim i Kuvendit nr.39, datë 10.6.2010	Për disa shtesa në vendimin nr.4, datë 16.9.2009 “Për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve, byrosë dhe përbërjen e sekretariateve të Kuvendit”	4039
Vendim i Kuvendit nr.40, datë 10.6.2010	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr.3, datë 16.9.2009 “Për caktimin e përbërjes së Komisioneve të Përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar	4039
Dekret nr.6600 datë 11.6.2010	Për lejim lënieje të shtetësisë shqiptare	4040
Dekret nr.6610 datë 18.6.2010	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	4041
Dekret nr.6619 datë 21.6.2010	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	4042
Akt normativ nr.2, datë 16.6.2010	Për një shtesë në ligjin nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar	4042
Vendim i KM nr.413, datë 26.5.2010	Për miratimin e strukturës e të organikës, si dhe të strukturës e të niveleve të pagave të Autoritetit të Aviacionit Civil	4043

Vendim i KM nr.417, datë 2.6.2010	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të një sipërfaqeje nga trualli funksional i pronës nr.246, “Ish-Bateri ABD”, në Shkëmbin e Kavajës, Shkallnuer, Durrës dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar	4048
Vendim i KM nr.419, datë 2.6.2010	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Skënderbegas të qarkut të Elbasanit	4052
Vendim i KM nr.420, datë 2.6.2010	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Bogovë të qarkut të Beratit	4053
Vendim i KM nr.421, datë 2.6.2010	Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Shkodër të qarkut të Shkodrës.....	4054
Vendim i GJK nr.31, datë 18.6.2010	Me objekt: 1. Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i ligjit nr.10159, datë 15.10.2009 “Për shfuqizimin e ligjit nr.8340/1, datë 6.5.1998 “Për rregullimin e pasojave që kanë rrjedhur nga zbatimi i dekretit nr.204, datë 5.6.1992 “Për pasurinë e sindikatave””. 2. Pezullimi i zbatimit të ligjit nr.10159, datë 15.10.2009 “Për shfuqizimin e ligjit nr.8340/1, datë 6.5.1998 “Për rregullimin e pasojave që kanë rrjedhur nga zbatimi i dekretit nr.204, datë 5.6.1992 “Për pasurinë e sindikatave””	4055
Udhëzim i MPCSSH nr.423/5, datë 31.5.2010	Për disa ndryshime në udhëzimin nr.423, datë 24.2.2010 “Për kriteret e përdorimit të fondit të pashpërndarë të mbrojtjes sociale”	4067
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të vdekur të shtetasit Rexhep Ypi	4067
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Fatmir Osmani dhe caktimin e motrës si kujdestare për administrimin e pasurisë së tij	4067

REZOLUTË

PËR RAPORTIN E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM “MBI GJENDJEN E KRIMINALITETIT PËR VITIN 2009”

Duke konsideruar se:

- Prokuroria e Republikës është një nga institucionet kushtetuese më themelore në luftën kundër formave të ndryshme të veprave penale, sidomos në luftën kundër krimit të organizuar, trafikëve dhe korrupsionit;

- Ndjekja penale, efikase dhe e suksesshme, mund të realizohet vetëm nga një institucion solid, i pavarur, i përgjegjshëm e i pakorruptueshëm, i cili moto dhe pikësynim madhor ka ligjshmërinë;

- Objektivat e procesit të integritimit euroatlantik kërkojnë standarde akoma më të larta dhe rezultate të qëndrueshme e në rritje progresive edhe për organin e Prokurorisë;

- Bashkëpunimi mes institucioneve dhe agjencive të zbatimit të ligjit është garancia themelore, e cila e bën të qëndrueshme e të sigurt luftën kundër krimit dhe korrupsionit;

- Raportimi në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit dhe përparësitë e luftës kundër kriminalitetit përbën mundësinë më të rëndësishme institucionale e ligjore për Kuvendin, jo vetëm për të analizuar punën e Prokurorisë, por edhe për t'i përcjellë asaj, në ushtrim të sovranitetit popullor, mesazhin e tolerancës zero ndaj të gjitha formave të krimit.

Kuvendi i Shqipërisë konstaton:

I. Për luftën ndaj formave të krimit

- Ka një reduktim të qartë dhe të ndjeshëm të intensitetit dhe formave të kriminalitetit në Republikën e Shqipërisë, siç vihet re nga raporti që i është paraqitur Kuvendit.

- Është për t'u përshëndetur përpjekja për të intensifikuar luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore, gjë e cila ka sjellë uljen e ndjeshme të këtij fenomeni.

- Ekzistojnë ndjeshëm përpjekjet për të intensifikuar luftën ndaj trafikut të lëndëve narkotike, gjë e cila ka sjellë dhe uljen e këtij fenomeni në Shqipëri, por ashpërsia e politikës penale në trajtimin dhe ndjekjen e këtyre rasteve do ta bënte më efektive punën e Prokurorisë.

- Është për t'u përshëndetur puna e mirë e Prokurorisë në luftën kundër korrupsionit. Krijimi dhe funksionimi i suksesshëm i grupeve task-forcë, të ngritura në Tiranë dhe në 6 rrethe të tjera, ka hapur një kapitull të ri në betejën kundër korrupsionit.

- Lufta ndaj korrupsionit në administratën shtetërore, si në atë qendrore dhe në atë vendore, është në një fazë përgjithësisht pozitive, por ajo ka nevojë për një hetim të shpejtë dhe efikas. Disa kallëzime të depozituara nga Kuvendi apo Këshilli i Ministrave janë akoma pa përgjigje.

- Ekzistojnë përpjekje për të luftuar pastrimin e parave, por kjo mbetet ende një sfidë e papërbushur e Prokurorisë. Disa raste, edhe pse kanë qenë tërësisht të mbështetura me prova nga agjencitë përkatëse, nuk kanë gjetur mbështetjen e Prokurorisë.

- Lufta ndaj korrupsionit në radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve ka pasur një zhvillim pozitiv gjatë vitit 2009, por ajo është ende në nivelin fillestar.

II. Për bashkëpunimin institucional

- Bashkëpunimi i Prokurorisë së Përgjithshme me Kuvendin e Shqipërisë, gjatë seancave dëgjimore në procesin e miratimit të ligjeve, ka qenë në nivel të kënaqshëm.

- Bashkëpunimi mes institucioneve, sidomos nëpërmjet ngritjes së grupeve task-forcë, ka sjellë impakt pozitiv në luftën kundër krimit, korrupsionit dhe moszbatimit të ligjit zgjedhor. Akuzat e ngritura nga disa drejtues institucionesh, si KLSH-ja, ILDKP-ja dhe KQZ-ja, jo vetëm që nuk kanë marrë përgjigje të qartë, por ka munguar dialogu pozitiv me to, duke dëmtuar efikasitetin e kësaj lufte. Trajtimi me objektivitet i raporteve të KLSH-së ka qenë dhe mbetet veçanërisht një shqetësim i përhershëm i Kuvendit të Shqipërisë prej më shumë se 10 vjetësh, ndaj kërkon një trajtim serioz dhe të përgjegjshëm.

- Marrëdhëniet juridiksionale me jashtë kanë një përmirësim të ndjeshëm në procesin e ekstradimeve të shtetasve nga jashtë brenda dhe anasjelltas, duke mos pasur më shqetësimin e

dështimit të ekstradimeve, por mbetet ende pa përgjigje shqetësimi i Kuvendit lidhur me urdhrat e arrestit ndërkombëtar dhe aplikimi i rasteve të transferimit të procedimit, duke u mjaftuar vetëm me justifikimin e mosardhjes në kohë të dokumenteve. Zgjidhja e këtij shqetësimi të hershëm mes Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme duhet të zhvillohet në kuadër të ligjit të ri, të miratuar me pjesëmarrjen e të dyja institucioneve gjatë diskutimit në Kuvend.

III. Për organizimin e brendshëm dhe drejtësinë e institucionit

- Prokuroria ka bërë përpjekje për rritjen e kapaciteteve hetimore të Prokurorisë, por ato mbeten ende të dobëta.

- Ngritja e strukturave task-forcë në Tiranë dhe në 6 rrethe prej Prokurorisë së Përgjithshme ka pasur gjithë mbështetjen e duhur dhe pritshmëri të madhe, por, duke qenë në hapat e saj të parë, mbetet ende punë për të bërë për ngritjen e tyre në lartësinë e duhur.

- Ekzistojnë përpjekje të ndjeshme të këtij institucioni për të ndryshuar gjendjen në të cilën ndodhej, duke organizuar më mirë punën e brendshme dhe modeluar disa rregulla, që kanë të bëjnë me promovimin e prokurorëve, por është ende në hapa fillestarë lufta kundër korrupsionit brenda sistemit të Prokurorisë.

Kuvendi kërkon nga Prokuroria për vitin 2010:

- Të krijë strategji të qarta, nga njëra anë, për trajnimin dhe rritjen e performancës së institucionit dhe, nga ana tjetër, për gjetjen dhe largimin nga sistemi të prokurorëve të paafte dhe të korruptuar;

- Të rrisë kapacitetet investigative të prokurorëve, duke i dhënë përparësi të ndjeshme fillimit të çështjeve, kryesisht nga ana e tyre dhe jo vetëm nëpërmjet kallëzimeve të bëra nga shtetasit;

- Të rrisë bashkëpunimin me të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit në Shqipëri, duke iu nënshtruar dialogut dhe luftës me tolerancë zero ndaj krimit;

- Të rrisë bashkëpunimin ndërkombëtar me agjencitë homologe, duke i dhënë përgjigje në një kohë të shpejtë dhe me efikasitet të gjitha rasteve të ekstradimit apo urdhër-arresteve ndërkombëtare, edhe në kuadër të ligjit të ri për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale;

- Të vijojë intensifikimin e luftës ndaj të gjitha formave të krimit, trafikëve dhe krimit të organizuar, veçanërisht në ndërtimin e një vizioni të qartë për forcimin dhe ashpërsimin e politikës penale ndaj këtyre veprave;

- Të intensifikojë luftën ndaj korrupsionit në administratën qendrore dhe në atë vendore si ndaj zyrtarëve, ashtu dhe ndaj ish-zyrtarëve të këtij vendi, duke kryer hetime të shpejta dhe efikase. Në mënyrë të veçantë, lufta ndaj korrupsionit në sistemin e drejtësisë të jetë një përparësi themelore e Prokurorisë, duke forcuar kapacitetet investigative;

- Të intensifikojë luftën ndaj pastrimit të parave, duke rishikuar të gjitha dosjet e depozituara nga agjencitë përkatëse, pa pasur asnjë dallim ndaj të gjithë zyrtarëve apo shtetasve të këtij vendi, përfshi këtu dhe përkatësinë e tyre politike;

Kuvendi angazhohet të mbështesë Prokurorinë në çdo kërkesë të saj për heqjen e imunitetit të zyrtarëve me imunitet, për kërkesat që kanë lidhje me korrupsionin apo pastrimin e parave.

10 qershor 2010

VENDIM
Nr.39, datë 10.6.2010

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 4, DATË 16.9.2009 “PËR ZGJEDHJEN E ZËVENDËSKRYETARËVE, BYROSË DHE PËRBËRJEN E SEKRETARIATEVE TË KUVENDIT”

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 55 pika 1 dhe neneve 8 e 10 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetares së Kuvendit, pas këshillimit me Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin nr. 4, datë 16.9.2009 “Për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve, byrosë dhe përbërjen e sekretariateve të Kuvendit”, bëhen këto shtesa:

- I. Në fund të pikës II shtohen fjalët “dhe Namik Dokle”.
- II. Në pikën III, në përbërjen e Sekretariateve të Kuvendit bëhen këto shtesa:
 1. Në Sekretariatit për Buxhetin e Kuvendit, deputeti Erion Braçe zgjidhet sekretar, ndërsa deputetja Mimi Kodheli zgjidhet anëtare.
 2. Në Sekretariatit për Procedurat dhe Votimet, deputeti Armando Subashi zgjidhet anëtar.
 3. Në Sekretariatit për Statusin e Deputetit, deputetja Ermonela Felaj zgjidhet anëtare.
 4. Në Sekretariatit për Kërkimin Shkencor, Bibliotekën dhe Botimet Parlamentare, deputeti Fatmir Toçi zgjidhet anëtar.
 5. Në Sekretariatit për Marrëdhëniet me Jashtë, deputeti Qemal Minxhozi zgjidhet anëtar.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.40, datë 10.6.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 3, DATË 16.9.2009 “PËR CAKTIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 55 pika 1 dhe 21 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve, pas marrëveshjes së Kryetares së Kuvendit me Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin nr. 3, datë 16.9.2009 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

- I. Në pikën I bëhet ky ndryshim:
1. Deputeti Fatmir Xhafaj zgjidhet nënkryetar në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.
 2. Deputetja Mimi Kodheli zgjidhet nënkryetare në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.
 3. Deputeti Ilir Beqaj zgjidhet nënkryetar në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.
 4. Deputetja Valentina Leskaj zgjidhet kryetare në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.
 5. Deputetja Ermelinda Meksi zgjidhet kryetare në Komisionin për Integrimin Europian.
 6. Deputeti Et'hem Ruka zgjidhet kryetar në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.
 7. Deputetja Arta Dade zgjidhet nënkryetare në Komisionin për Politikën e Jashtme.
 8. Deputeti Ilir Gjoni largohet nga Komisioni për Politikën e Jashtme dhe zgjidhet nënkryetar në Komisionin për Sigurinë Kombëtare.
 9. Deputeti Namik Dokle largohet nga Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin dhe zgjidhet anëtar në Komisionin për Politikën e Jashtme.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

DEKRET
Nr.6600, datë 11.6.2010

PËR LEJIM LËNIEJE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohej lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Emri Shefit Grassler (Koldashi)
2. Jorgjeta Thodhoraq Qirici
3. Sigi Amanda Edmond Topi
4. Emilio Hasan Tabaku
5. Antonjeta Angjelin Satko (Banda)
6. Bora Altin Satko
7. Jens Altin Satko
8. Ilir Gani Mulgeci
9. Aulona Ilir Mulgeci
10. Redon Ilir Mulgeci
11. Olsion Gjençi Parangoni
12. Hans Ylli Skëndaj
13. Sokol Kadri Coha
14. Kledia Skënder Luniku

15. Fatma Mentor Çeliku
16. Daniel Arsen Çarçani
17. Agron Rustem Neziri
18. Sokol Dhimitër Hoxha
19. Jonard Arben Qinami
20. Enkeleda Rolandi Seiti (Nino)
21. Elona Elhami Spaho
22. Genta Ilir Allushi
23. Adnant Pjetër Prebibaj
24. Ilmi Sami Kroll (Agalliu)
25. Llesh Gjon Ndoj
26. Bledar Shpëtim Dragoj
27. Dario Bujar Mazreku
28. Darina Bujar Mazreku

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.6610, datë 18.6.2010

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të neneve 19 dhe 24 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U rijepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre:

1. Sefer Hamit Ibruli
2. Xhevahire Hysen Ibruli
3. Blendi Sefer Ibruli
4. Eldar Sefer Ibruli
5. Martha Gligor Sidheri (Baxho)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.6619, datë 21.06.2010

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të nenit 9, pika 7, nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”,

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij:

z. Ali Diyap Evsen

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

AKT NORMATIV
Nr.2, datë 16.6.2010

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7746, DATË 28.7.1993 “PËR HIDROKARBURET
(KËRKIMI DHE PRODHIMI)”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Pas shkronjës “c” të pikës 2 të nenit 12 të ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) “Marrëveshja Albpetrol” lejon Albpetrolin (“Albpetrol” sh.a.), të tregtojë produktet hidrokarbure për tregun vendas apo për eksport sipas çmimit të bursës ndërkombëtare për hidrokarburet. Ministria, që drejton veprimtarinë, miraton procedurat e tregimit të hidrokarbureve për këtë qëllim.”.

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.413, datë 26.5.2010

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS E TË ORGANIKËS, SI DHE TË STRUKTURËS E TË NIVELEVE TË PAGAVE TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 të ligjit nr.10 233, datë 11.2.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, të Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura e Autoritetit të Aviacionit Civil të jetë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Organika e Autoritetit të Aviacionit Civil të jetë sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve të Autoritetit të Aviacionit Civil të jenë sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Paga e grupit, kolona 1 e lidhjes nr.3 – diplomë e shkollës së lartë, është 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë.

5. Shtesa për vjetërsi në punë, kolona 2 e lidhjes nr. 3, jepet në masën 2%, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

6. Shtesa për kualifikim, kolona 3, e lidhjes nr. 3, përcaktohet, si më poshtë vijon:

Nëpunësit në Autoritetin e Aviacionit Civil përfitojnë shtesë për kualifikimin, gradën a titullin shkencor, të përcaktuar sipas lidhjes nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Kriteret për përfitimin e shtesës janë, si më poshtë vijon:

a) Kjo shtesë jepet kur përputhet fusha e kualifikimit, gradës a titullit shkencor, me përshkrimin e punës së nëpunësit, pas miratimit, rast pas rasti, nga Departamenti i Administratës Publike.

b) Në rastin kur nëpunësi ka kualifikim, gradë apo titull më të lartë se ai i përcaktuar për pozicionin e tij sipas lidhjes nr.4 bashkëlidhur, ai do të përfitojë vetëm shtesën e përcaktuar për pozicionin.

c) Në rastin kur nëpunësi ka kualifikim, gradë apo titull më të ulët se ai i përcaktuar për pozicionin e tij, sipas lidhjes nr.4 bashkëlidhur, ai do të përfitojë shtesën në përputhje me kualifikimin, gradën a titullin që ka.

ç) Në çdo rast si më sipër, pavarësisht nga kualifikimi, grada a titulli që ka nëpunësi, ai përfiton shtesën vetëm për gradën a titullin shkencor më të lartë që ka.

7. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 4 të lidhjes nr.3.

8. “Specialistët”, “Përgjegjësit e sektorit” apo “Drejtorët” në Autoritetin e Aviacionit Civil, që punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së administratës publike dhe për të cilat kërkohet, në mënyrë të detyrueshme, arsimi i lartë në degët “Inxhinieri elektronike” apo “Informatikë”, përfitojnë një shtesë për “kushte pune”, prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse. Zbatimi i kësaj shtese për pozicionet konkrete bëhet pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike dhe të Ministrisë së Financave, sipas përshkrimit të pozicioneve të punës.

9. Punonjësit mbështetës të Autoritetit të Aviacionit Civil të paguhën sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e punonjësve mbështetës.


10. Ngarkohen Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Ministri i Financave dhe drejtori ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data e emërimit të nëpunësve në detyrë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STRUKTURA E AUTORITETIT TE AVIACIONIT CIVIL

LIDHJA 1



ORGANIKA E AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
I.DREJTOR EKZEKUTIV	II-a	1
II.ZËVENDËSDREJTOR EKZEKUTIV	II-b	3
III.SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM		1
INSPEKTOR	III-a	1
IV.DREJTORIA E KONTROLLIT TË SHËRBIMIT TË NAVIGIMIT		9
DREJTOR	II-b	1
SEKTORI I KONTROLLIT TË PERSONELIT		2
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
INSPEKTOR	III-b	1
SEKTORI I INSPEKTIMIT TEKNIK		2
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
INSPEKTOR	III-b	1
SEKTORI I INSPEKTIMIT OPERACIONAL		3
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
INSPEKTOR	III-b	2
SEKTORI I LEJEVE TË FLUTURIMIT DHE KOORDINIMIT TË SLOTEVE		1
INSPEKTOR	III-b	1
V.DREJTORIA E AEROPORTEVE DHE SIGURISË		5
DREJTOR	II-b	1
SEKTORI I MBIKËQYRJES SË AEROPORTEVE DHE I CERTIFIKIMEVE		1
INSPEKTOR	III-b	1
SEKTORI I INSPEKTIMIT TË PAJISJEVE NDIHMËSE NAVIGACIONALE		1
INSPEKTOR	III-b	1
SEKTORI I SIGURISË DHE KOORDINIMIT TË EMERGJENCAVE		2
INSPEKTOR	III-b	2
VI.DREJTORIA E SIGURISË AJRORE		11
DREJTOR	II-b	1
SEKTORI I VLEFSHMËRISË AJRORE		2
INSPEKTOR	III-b	2
SEKTORI I OPERIMEVE AOC CERTIFIKATA E OPERIMIT AJROR		3
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
INSPEKTOR	III-b	2
SEKTORI I LICENCIMIT TË STAFIT DHE EKUIPAZHIT		2
INSPEKTOR	III-b	2
SEKTORI I REGJISTRIMIT TË AVIONËVE		1
INSPEKTOR	III-b	1
SEKTORI I MIRËMBAJTJES		2
INSPEKTOR	III-b	2

VII.DREJTORIA E STANDARDIZIMIT DHE IMPLEMENTIMIT		7
DREJTOR	II-b	1
SEKTORI I STANDARDIZIMIT TEKNIK		3
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
INSPEKTOR	III-b	2
SEKTORI I IMPLEMENTIMIT		3
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
INSPEKTOR	III-b	2
VIII.DREJTORIA EKONOMIKE		5
DREJTOR	II-b	1
SEKTORI I PLANIFIKIMIT FINANCIAR DHE TARIFAVE		3
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
SEKTORI I LICENCIMIT TË OPERATORËVE AJRORË		1
INSPEKTOR	III-b	1
IX.DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		13
DREJTOR	II-b	1
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE		1
SPECIALIST	IV-a	1
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE PUBLIKUN		2
SPECIALIST	IV-a	2
SEKTORI I PROKURIMEVE		2
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	1
SEKTORI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT		1
SPECIALIST	III-b	1
SEKTORI I SHËRBIMEVE		6
SPECIALIST	IV-a	2
PASTRUES		1
SHOFER		3
PUNONJËS GJITHSEJ		55

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË AUTORITETIN E AVIACIONIT CIVIL

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT	SHTESA PËR KUSHTE PUNE
		1	2	3		
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Titullar i institucionit	II-a	12 000	2%		105.000	15 000
Zëvendëstitullar i institucionit	II-b	12 000	2%		88.000	15 000
Drejtor drejtorie	II-b	12 000	2%		88.000	0
Përgjegjës sektori Inspektor auditi	III-a	12 000	2%		69.000	0
Përgjegjës sektori	III-a/1	12 000	2%		60.000	0
Inspektor Specialist	III-b	12 000	2%		52.000	0
Specialist	IV-a	12 000	2%		41.000	0

Lidhja nr.4

POZICIONI	KUALIFIKIMI/GRADA/TITULLI SHKENCOR	SHTESA (LEKË/MUAJ)
Titullar i institucionit	Profesor	30 000
	Profesor i asociuar	25 000
Zëvendëstitullar i institucionit Drejtor drejtorie në institucion	Doktor i Shkencave	20 000
	Doktor i Shkencave	25 000
Përgjegjës sektori Inspektor Specialist	Studime të thelluara pasuniversitare/master i nivelit të dytë/studime specializuese afatgjata	10 000
	Studime të thelluara pasuniversitare/master i nivelit të dytë	20 000

Shënim. Vlerat 20 000 lekë, për diplomat “Master i nivelit të dytë/Studime të thelluara pasuniversitare” dhe 25 000 lekë, për gradën shkencore “Doktor i Shkencave”, aplikohen për nëpunësit që i kanë përfituar diplomat përkatëse në universitet, apo shkollat e larta të vendeve të përcaktuara sipas listës që i bashkëlidhet udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Financave dhe Departamentit të Administratës Publike.

VENDIM
Nr.417, datë 2.6.2010

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTERIA E MBROJTJES
MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, PËR DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË RRUGËVE, TË NJË SIPËRFAQEJE NGA TRUALLI FUNKSIONAL I
PRONËS NR.246, "ISH-BATERI ABD", NË SHKËMBIN E KAVAJËS, SHKALLNUER,
DURRËS DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME, SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, shkronja "b" e 15, shkronja "c" të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të sipërfaqes prej 4 762.8 (katër mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy pikë tetë) m² nga trualli funksional i pronës nr.246 "Ish-Bateri ABD", në Shkëmbin e Kavajës, Shkallnuer, Durrës, sipas genplanit bashkëlidhur, për ta përdorur për nevoja urbanistike (rrugë publike).

2. Në listën e pronave bashkëlidhur vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar, të hiqet sipërfaqja 4 762.8 (katërmijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy pikë tetë) m² nga trualli funksional i pronës nr.246, "Ish-Bateri ABD", në Shkëmbin e Kavajës, Shkallnuer, Durrës.

3. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve ndalohen të ndryshojnë destinacionin e sipërfaqes së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojnë atë ose t'ua japin në përdorim të tretëve.

4. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit e Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, para fillimit të punimeve, detyrohen të bëjnë rrethimin e pronës dhe spostimin e rrjeteve inxhinierike që preken gjatë punimeve, duke rehabilituar infrastrukturën që preket gjatë punimeve, për funksionimin e rrugës sipas parametrave dhe kushteve teknike.

5. Pas këtyre veprimeve paraprake dhe marrjes në dorëzim të objekteve të rehabilituara, Ministria e Mbrojtjes detyrohet të bëjë dorëzimin sipas legjislacionit në fuqi, për kalimin në administrim të sipërfaqes 4 762.8 (katër mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy pikë tetë) m², Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve.


6. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për ndjekjen dhe zbatimin e procedurave të nevojshme, për kalimin në përgjegjësi administrimi të kësaj sipërfaqeje, për nevoja urbanistike, zgjerimin e rrugës publike.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLAN VENDOSJA E REP.USHT.NR.2230 (ISH BATERIA E ABD) SHKËMBI I KAVAJËS DURRËS
(Sipërfaqja ku do të kalojë traseja e rregës dytësore)

Sistemi i koordinatave Boterore (WGS 84)




Punoi: N/Tog Arjol HYKA *AH*
N/Tog Ferdinand BERBERI *AH*
Shefi Sek Gjeomatikes
Major Ilambi ZOTO *ZOTO*

Shkalla 1:2500

Drejtoresha IGJU se
Ing.Dipl. Miranda ZEKA

Komandati i forcave tokesore
Gjeneral Brigade Shpetim Spahiu

PLAN VENDOSJA E REP. USHT XHENJO SHKEMBI KAVAJES DURRES.



PUNOI
TOPOGRAF ALEKS ZYBA
Ing. ILIR CEKREZI
SHEFI I DEGES GJF-OMATIKEC

SHK. 1:2500

Prof. Asc. Dr. MYSLIM PASHA



VENDIM
Nr.419, datë 2.6.2010

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS SKËNDERBEGAS, TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2,3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, (që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Skënderbegas të qarkut të Elbasanit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Skënderbegas të qarkut të Elbasanit, miratuar me vendimin nr.728, datë 23.11.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Skënderbegas, të qarkut të Elbasanit”.

2. Ngarkohet Ministria e Brendshme dhe komuna Skënderbegas, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Skënderbegas

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-4	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
6-11	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik (pasuritë: me nr.7,8,9,10,11; ambulancat ndodhen brenda shkollave).	Në pronësi
12-34	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore (pasuria me nr.13, kopshti ndoshet brenda ambientit të shkollës).	Në pronësi
35-62	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
63-100	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
637-639,643,644,647-649, 653,654,658,659,663,664,	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të	Në përdorim

668,672,678,679,686-685, 688-690	ushqimit (toka produktive).	
640-642,645,646,650- 652,656,657,660-662, 665-667,669-671,673-677,680- 682,686-687,691-693	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive).	Në pronësi
694-827	Infrastruktura (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi

VENDIM
Nr.420, datë 2.6.2010

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS BOGOVË, TË QARKUT TË BERATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2,3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, (lidhja nr.1), që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Bogovë të qarkut të Beratit, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Bogovë të qarkut të Beratit, miratuar me vendimin nr.1378, datë 17.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Bogovë, të qarkut të Beratit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna e Bogovës, për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Bogovë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
174-179	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
180,181	Prona që përdoren për realizimin e veprimtrive social-kulturore.	Në pronësi
182	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
183	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative.	Në pronësi

185-245	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
246,247,249-259	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
260-270	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile.	Në pronësi
271-282	Varrezat publike	Në pronësi
286-339	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
340-359	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
360-371	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive).	Në pronësi
380-392	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi

VENDIM
Nr.421, datë 2.6.2010

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE (TË PJESSHME) TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË SHKODËR, TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Shkodër, të qarkut të Shkodrës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 196 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 855 (tetëqind e pesëdhjetë e pesë).

2.Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
7,13-19,21-23	Prona që përdoren në fushën administrative.	Në pronësi
32-73,851,852,853,	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
78-86,90-95,854	Prona që përdoren në fushën e shëndetit publik (shërbim parësor).	Në pronësi
216,218-255 (pjesa e paprivatizuar e 225), 228-234,	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore.	Në pronësi
241-248,	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social.	Në pronësi
107-109,121-135,173-205,	Zhvillim ekonomik	Në pronësi
330-403	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile.	Në pronësi
621-631	Prona që përdoren në fushën e ndriçimit publik.	Në pronësi
619-620	Infrastrukturë vendore	Në pronësi
578,579	Shërbim funeral	Në pronësi

VENDIM
Nr.31, datë 18.06.2010

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “
Petrit Piloçi	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datë 9.2.2010 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.1, 2 Akti, që i përket:

KËRKUES: 1. BASHKIMI I SINDIKATAVE TË PAVARURA TË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga avokat Baftjar Rusi me prokurë.

2. SINDIKATA E PAVARUR E MINATORËVE TË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga avokat Baftjar Rusi me prokurë.

3. KONFEDERATA E SINDIKATAVE TË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga avokat Artan Hajdari dhe Elira Kokona me prokurë.

4. SINDIKATA E PAVARUR E TRANSPORTIT TË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga avokat Thimjo Kondi me prokurë.

5. SINDIKATA RAJONALE ELBASAN, përfaqësuar nga avokat Thimjo Kondi me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj me autorizim.

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari me autorizim.

OBJEKTI:1. Shfuqizimi si i papajtuësëm me Kushtetutën e ligjit nr.10159, datë 15.10.2009 “Për shfuqizimin e ligjit nr.8340/1, datë 6.5.1998 “Për rregullimin e pasojave që kanë rrjedhur nga zbatimi i dekretit nr.204, datë 5.6.1992 “Për pasurinë e sindikatave””.

2. Pezullimi i zbatimit të ligjit nr.10159, datë 15.10.2009 “Për shfuqizimin e ligjit nr.8340/1, datë 6.5.1998 “Për rregullimin e pasojave që kanë rrjedhur nga zbatimi i dekretit nr.204, datë 5.6.1992 “Për pasurinë e sindikatave””.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 16, 17, 41, 42, 46, 50, 122, 131/a dhe 134, pikat 1/f dhe 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 11 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) dhe neni 1 i Protokollit nr.1 të KEDNJ-së; neni 5 i Kartës Sociale Europiane, ratifikuar me ligjin nr.8960, datë 24.10.2002; nenet 45, 49, 50 dhe 51 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Petrit Pllloçi; përfaqësuesit e kërkuësve, që kërkuan pranimin e kërkesës; përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, që kërkuar rrëzimin e saj dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Me dekretin nr.204, datë 5.6.1992 të Presidentit të Republikës, pasuria e luajtshme dhe e paluajtshme që shërbente për veprimtarinë sindikale dhe edukimin profesional e sindikal të punonjësve, u la në pronësi të sindikatave. Sipas këtij dekreti, ndarja e kësaj pasurie do të bëhej me marrëveshje ndërmjet sindikatave dhe mosmarrëveshjet lidhur me ndarjen e pasurisë do të zgjidheshin nga gjykata (neni 2). Po sipas tij (neni 3), pasuria e luajtshme dhe e paluajtshme dhe vlerat monetare të ish-Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë do të bllokoheshin, inventarizoheshin dhe vlerësoheshin nga një komision i ngritur nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, duke marrë si bazë gjendjen faktike të muajit mars të vitit 1991.

Dekreti i mësipërm i Presidentit nuk u kundërfirmos nga Kryeministri ose nga Ministri i Financave, si dhe nuk iu paraqit për miratim Kuvendit në sesionin më të afërt (nenet 28/19 dhe 29 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”).

Në datë 6.5.1998, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr.8340, me anë të të cilit vendosi të mos e miratojë dekretin nr.204, datë 5.6.1992 “Për pasurinë e sindikatave”. Po në këtë datë, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr.8340/1 “Për rregullimin e pasojave që kanë rrjedhur nga zbatimi i dekretit nr.204, datë 5.6.1992 “Për pasurinë e sindikatave””. Sipas këtij ligji, pasuritë e sindikatave të fituara nga zbatimi i dekretit nr.204 konsiderohen pasuria e luajtshme dhe e paluajtshme dhe vlerat monetare të ish-Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë, sipas inventarizimit dhe vlerësimit të bërë nga Komisioni i ngritur nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë në muajin qershor të vitit 1992, mbi bazën e gjendjes faktike të muajit mars të vitit 1991. Ligji parashikonte, gjithashtu, se aktmarrëveshjet e arritura ndërmjet sindikatave, për ndarjen e pasurisë, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, kanë vlerë juridike me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

Në datë 15.10.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr.10159, i cili shfuqizon ligjin nr.8340/1, datë 6.5.1998 “Për rregullimin e pasojave, që kanë rrjedhur nga zbatimi i dekretit nr.204, datë 5.6.1992 “Për pasurinë e sindikatave””. Ky ligj, mes të tjerash, parashikon se, për marrëdhëniet e detyrimit, të krijuara ndërmjet sindikatave dhe të tretëve, si dhe për kontratat 4056

e lidhura ndërmjet tyre, për shkak të ushtrimit të tagrave të gëzimit dhe të posedimit prej sindikatave mbi pasuritë shtetërore të paluajtshme, zbatohen dispozitat e Kodit Civil (neni 2). Ekzekutimi i detyrimit, që rrjedh nga një marrëdhënie detyrimi ndërmjet sindikatës, në cilësinë e kreditorit dhe një pale të tretë, në cilësinë e debitorit, kryhet në favor të shtetit (neni 3), ndërsa për identifikimin e pasurive të sindikatave ligji ngarkon Agjencinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike (neni 4).

Ligji i mësipërm është kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata) nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë dhe Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Shqipërisë, me kërkesën e datës 2.12.2009. Ky ligj është kundërshtuar edhe nga Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë, me kërkesën datë 7.12.2009, Sindikata e Pavarur e Transportit dhe Sindikata Rajonale Elbasan, me kërkesën datë 7.1.2010. Duke qenë se këto kërkesa kanë objekt të njëjtë, Gjykata vendosi bashkimin e tyre në një gjykim të vetëm.

Kërkuesit kanë parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto pretendime për shfuqizimin e ligjit objekt kërkesë:

- Ligji i kundërshtuar cenon *parimin kushtetues të sigurisë juridike*, pasi ai cenon të drejtat e fituara mbi një bazë legjitime.

- Ligji nr.10159, datë 15.10.2009 cenon të drejtën e pronës, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi ligji nr.8340/1, datë 6.5.1998 i ka bërë sindikatat pronare të pasurive të transferuara prej tij, pasuri këto të regjistruara edhe në zyrat përkatëse të regjistrimit të pasurive të paluajtshme; me shfuqizimin e ligjit nr.8340/1, datë 6.5.1998 realizohet *de facto* dhe *de jure* shpronësimi i sindikatave në mënyrë antikushtetuese, pasi nuk respektohet asnjë prej kriterëve të përcaktuara nga neni 41 i Kushtetutës; dekreti nr.204 solli pasoja faktike si të ishte i vlefshëm juridikisht për një periudhë prej 6 vitesh (1992-1998), pasoja që u pranuan dhe nga ligjvënësi i kohës, i cili miratoi ligjin nr.8340/1, datë 6.5.1998 pikërisht për rregullimin e këtyre pasojave; ky ligj nuk ua ka dhënë objektet sindikatave në administrim deri më 31.12.2020, por në pronësi me tagra të kufizuara dhe sanksioni i vetëm, në rast shmangie nga objektivat sindikaliste, është jo rikthimi i pronës te shteti, por mospërtëritja e kontratës së qiradhënies; ligji nr.8340/1, datë 6.5.1998 është ligj vlerësues që legjitimon me fuqi prapavepruese pasojat e ardhura nga dekreti nr.240, pra ligjëron titullin e pronësisë të sindikatave.

- Ligji i kundërshtuar cenon të drejtën e lirisë sindikaliste, të garantuar nga neni 50 i Kushtetutës, pasi cenon pavarësinë financiare të saj, të kuptuar si tërësia e burimeve ekonomike për financimin e këtyre organizatave; sindikatat i kanë gëzuar pronat e tyre plotësisht, të pashqetësuara dhe në mirëbesim për një periudhë shumë të gjatë kohore, kanë krijuar marrëdhënie të shumta me të tretë dhe asnjë akt formal ose joformal i cilësdo strukturë të shtetit nuk i ka lënë ato të kuptojnë se në të ardhmen situata e tyre do të ndryshonte negativisht.

- Ligji është i papajtuëshëm edhe me nenin 11 të Kushtetutës, pasi kjo dispozitë kushtetuese nuk mbron vetëm veprimtarinë ekonomike fitimprurëse, por edhe pronën dhe veprimtarinë ekonomike jofitimprurëse të sindikatave e të organizatave të tjera.

- Ligji është i papajtuëshëm me kërkesat e nenit 118 (pikat 1 dhe 2) të Kushtetutës, pasi problematika ose çështje të cilat, për shkak të natyrës së tyre, duhet të rregullohen me ligj, nuk mund të rregullohen me akte nënligjore.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në mënyrë të përmbledhur parashtroi:

- Kërkuesit nuk legjitimohen t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, pasi ata nuk kanë argumentuar interesin e tyre.

- Dekreti nr.204, datë 5.6.1992, që është akti i vetëm që parashikonte pronësinë e sindikatave, nuk mori fuqi ligjore; në relacionin e propozuesve të dy ligjeve të vitit 1998 dhe as në relacionin e Komisionit të Ligjeve nuk propozohet të përfshihet në ligj fakti që pasuritë e sindikatave të jenë në pronësi të tyre, por propozohet vendosja e kontrollit mbi administrimin e kësaj pasurie; në rast se ligji nr.8340/1, datë 6.5.1998 do tu njëhte pronësinë sindikatave, kjo do të rezultonte në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë në përmbajtjen e tij; neni 7 i ligjit nr.8340/1, datë 6.5.1998 nënkupton qartë që shteti është pronar me tagra të plota dhe vullnetin e tij e pasqyron në mënyrë të

shprehur kur kalon një pasuri nga pronësia e tij në pronësinë e dikujt tjetër, si në rastin e pasurive që i kalojnë organeve të pushtetit vendor (neni 7); posedimi dhe gëzimi (administrimi) nuk janë tagra të mjaftueshme për të qenë pronar, nëse nuk zotërohet dhe tagri i disponimit; fakti që neni 8 i ligjit nr.8340/1, datë 6.5.1998 ngarkon Kontrollin e Lartë të Shtetit (KLSH), që ka për objekt të punës kontrollin dhe miradministrimin e pasurive shtetërore, të kontrollojë administrimin e pasurive të paluajtshme deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, tregon se ligjvënësi i konsideron këto pasuri shtetërore; shfuqizimi i ligjit nr.8340/1, datë 6.5.1998 me anë të një ligji të posaçëm është një praktikë legjislative e njohur dhe ligji i kundërshtuar rregullon pasojat juridike që rrjedhin nga ky shfuqizim.

- Parimi i sigurisë juridike nuk cenohet, pasi kërkuesit nuk janë mbajtës të së drejtës së pronësisë, por vetëm i posedojnë dhe i gëzojnë këto pasuri.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Këshilli i Ministrave, në mënyrë të përmbledhur, parashtroi:

- Shteti është pronar i vetëm i pasurive të administruara nga sindikatat, të cilat përgjatë kohës së administrimit kapërcyen në mënyrë abuzive tagrat e të drejtave reale të dhëna; Kuvendi i Republikës së Shqipërisë shprehu qartë dhe pa ekuivok vullnetin e tij për moskalimin e pronësisë mbi këto pasuri nëpërmjet mosmiratimit të dekretit nr.204, datë 5.6.1992; termi i përdorur në ligjin nr.8340/1, datë 6.5.1998 “*të fituara nga zbatimi i dekretit*”, bën referim te sendet dhe gjendjen juridike të tyre në vitin 1992, pra ka qëllim identifikimin e pasurive; termi “*të përfituara*” i referohet pasurive që mund të kishin rrjedhur si pasojë e futjes në qarkullim civil të grupit të pasurive të përshkruara në nenin 1 të ligjit.

- Sindikatat administronin pasuritë shtetërore, por nuk kanë qenë pronare të tyre, sepse u mungonte një prej tagrave të pronësisë që është e drejta e disponimit/tjetërsimit; në tekstin e nenit 6 të ligjit nr.8340/1, datë 6.5.1998 përdoret shprehimisht termi “*administrimi i pasurive*”; ligji nr.8340/1, datë 6.5.1998 është tranzitor për nga natyra, sepse ka dalë për rregullim pasojash dhe jo për rregullim pozitiv definitiv; rregulli bazë i këtij ligji është ndalimi i shprehur i tjetërsimit, i vendosur për të mbështetur lirinë sindikaliste deri në forcimin ekonomik të mjaftueshëm të sindikatave, si dhe për t’i paraprirë faktit juridik të fitimit të pronësisë me parashkrim (me 31.12.2020 sindikatat do të kishin të drejtën e posedimit për 18 vjet e 6 muaj).

- Ligji i kundërshtuar nuk cenon parimin e sigurisë juridike, pasi nuk merr përsipër të përkeqësojë situatën e pronësisë së sindikatave, sepse ato asnjëherë nuk kanë fituar një titull pronësie mbi pronat që kanë pasur në administrim; fitimi i një të drejte nëpërmjet akteve inekzistente dhe pa fuqi juridike nuk mund të ruhet si gjendje nëpërmjet invokimit të parimit të sigurisë juridike.

- Pretendimi për shkelje të neneve 46 dhe 50 të Kushtetutës, nenit 11 të KEDNJ-së dhe nenit 5 të Kartës Sociale Ekonomike nuk qëndron, pasi ligji nr.10159, datë 15.10.2009 nuk ka suprimuar bazën ekonomike të sindikatave; shteti ka lejuar administrimin e pasurive shtetërore të cilat, në kushtet e një miradministrimi, duhet të kenë krijuar të ardhura financiare të bollshme për të siguruar veprimtarinë sindikale.

- Evokimi nga kërkuesit i nenit 118 të Kushtetutës, si bazë kushtetuese e pretendimeve të tyre, është i pavend, sepse kërkesa ka si objekt vlerësimin e kushtetutshmërisë së një ligji dhe jo të akteve nënligjore.

II

Gjykata Kushtetuese, në seancë plenare, mori në shqyrtim kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit nr.10159, datë 15.10.2009 “Për shfuqizimin e ligjit nr.8340/1, datë 6.5.1998 “Për rregullimin e pasojave që kanë rrjedhur nga zbatimi i dekretit nr.204, datë 5.6.1992 “Për pasurinë e sindikatave””. Në kuptim të nenit 45 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullim, për arsye se nuk gjeti argumente bindëse për cenimin e interesave shtetërorë, shoqërorë ose të individëve, si rrjedhojë e zbatimit të këtij ligji.

III

Lidhur me pretendimin e subjekteve të interesuara për mungesën e legjitimitit të kërkuësve për të iniciuar gjykimin kushtetues

Përfaqësuesi i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në seancë gjyqësore pretendoi se kërkuësit nuk legjitimohen t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, pasi ata nuk kanë argumentuar interesin e tyre.

Lidhur me këtë pretendim, Gjykata Kushtetuese rithekson se Kushtetuta ka parashikuar një numër të zgjeruar subjektësh që mund t'a vënë atë në lëvizje për të iniciuar një gjykim kushtetues. Në nenin 134, pika 1, shkronja "f" të saj parashikohen si subjekte të tilla edhe organizatat. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se ligjvënësi kushtetues ka pasur për qëllim të përfshijë në rrethin e "organizatave të tjera" të gjitha ato shoqata, fondacione, sindikata ose organizime të tjera me karakter të ndryshëm, duke përfshirë edhe ato me karakter politik, që kanë qëllim mbrojtjen e interesave të grupeve të caktuara shoqërore. Pra, ligjvënësi kushtetues, edhe brenda kësaj kategorie, ka patur për qëllim ta zgjerojë atë, duke mos e kufizuar vetëm në shoqata, por duke i përcaktuar ato me termin e përgjithshëm "organizata" (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.16, datë 25.07.2008*).

Në lidhje me këto subjekte, ligjvënësi kushtetues ka parashikuar një të drejtë të kufizuar për të iniciuar gjykimin kushtetues, duke kërkuar që të provojnë lidhjen e domosdoshme, të drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.12, datë 28.04.2009; nr.16, datë 25.07.2008; nr.9, datë 19.03.2008; nr.41, datë 16.11.2007; nr.35, datë 10.10.2007; nr.11, datë 04.04.2007; nr.9, datë 26.02.2007*). Për pasojë, vetëm fakti që dispozitat e kundërshtuara mund të kenë ose kanë patur një efekt çfarëdo mbi kërkuësin, nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar nëse ai legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, por është e nevojshme të provohet se dispozita e kundërshtuar rregullon marrëdhënie që janë qëllimi i veprimtarisë së kërkuësit, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose, në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut.

Gjykata vëren se, në rastin në shqyrtim, kërkuësit janë persona juridikë, të regjistruar me vendim të gjykatës dhe, sipas statuteve përkatëse, janë organizata vullnetare që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre përfaqësimin e punonjësve shqiptarë, sipas kategorive përkatëse të punëmarrësve që përfaqësojnë, në mbrojtje të interesave të tyre social-ekonomike. Sipas statutit, burimet financiare të tyre realizohen nëpërmjet kuotës sindikaliste, si dhe nga pasuritë e luajshme dhe të paluajshme të fituara.

Megjithëse sindikatat kërkuëse i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar cenimin e një të drejte subjektive, siç është e drejta e pronës private, Gjykata vlerëson se qëllimi i sindikatave është që t'i shërbejnë veprimtarisë sindikaliste dhe në funksion të këtij qëllimi është edhe përdorimi i pasurive nga ana e tyre. Në këto kushte Gjykata vlerëson se sindikatat legjitimohen të iniciojnë këtë gjykim kushtetues.

IV

1. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike

Kërkuësit kanë pretenduar se ligji i kundërshtuar cenon parimin e sigurisë juridike, duke arsyetuar në thelb se ky ligj cenon të drejtën e pronës të fituar mbi një bazë legjitime, e drejtë kjo e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës; ligji nr.8340/1, datë 6.5.1998 i ka bërë sindikatat pronare të pasurive të transferuara prej tij, pasuri këto të regjistruara edhe në zyrat përkatëse të regjistrimit të pasurive dhe me shfuqizimin e tij realizohet *de facto* dhe *de jure* shpronësimi antikushtetues i sindikatave.

Gjykata Kushtetuese ka theksuar në jurisprudencën e saj se parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, është një nga parimet themelore në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Aspekte të këtij parimi janë edhe siguria juridike, mbrojtja e të drejtave të fituara, si dhe e pritshmërive të ligjshme. Siguria juridike presupozon, veç të tjerash, besueshmërinë e

qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.24, datë 12.11.2008; nr.9, datë 26.02.2007*). Rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre. Si rregull, nuk mund të mohohen interesa dhe pritshmëri të ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion dhe shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi sjell pasoja pozitive, konkretisht trajtim më të mirë financiar për subjektet përfituese. Sanksionimi i të drejtave dhe lirive të njeriut të pranuar në Kushtetutë dhe shoqërimi me masat për vënien e tyre në jetë duhet të synojnë përmirësimin dhe rritjen e standardeve të të drejtave (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 26.02.2007; nr.34, datë 20.12.2005*).

Gjykata Kushtetuese rithekson se në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve, kjo Gjykatë nisat nga prezumimi i pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën. Kjo do të thotë, se lidhur me jokushtetutshmërinë e pretenduar duhet të parashtrihen argumente bindëse, për t'i dhënë mundësi Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të zbatuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.16, datë 25.07.2008*).

Në kontekstin e çështjes në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese vëren se me ndryshimet që ndodhën në Shqipëri, ish-Bashkimet Profesionale ndryshuan si emërtimin, ashtu edhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të tyre dhe u krijuan parakushtet ligjore për krijimin e sindikatave të pavarura. Ligji nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, në nenin 14, parashikon: “*Sindikatat e njohura me ligj janë persona juridikë dhe mund të lidhin kontrata pune kolektive me subjektet publike ose private*”. Sindikatat fituan personalitet të plotë juridik, pjesë e të cilit ishte edhe pavarësia e plotë ekonomiko-financiare, pasi ato përfituan edhe administrimin e pasurive të ish-Bashkimeve Profesionale.

Me dekretin nr.204, datë 5.6.1992 të Presidentit të Republikës, pasuritë në administrim të sindikatave dhe që i shërbenin veprimtarisë sindikale dhe edukimit profesional e sindikal të punonjësve, kalonin në pronësi të tyre. Këto pasuri ishin ende pronë shtetërore dhe shteti, në këto kushte, si pronar i vetëm i tyre nuk kishte asnjë pengesë të dispononte mbi pasuritë e tij edhe në favor të sindikatave. Por ky dekret i Presidentit nuk u kundërfirmos nga Kryetari i Këshillit të Ministrave ose nga Ministri i Financave, nuk iu paraqit për miratim Kuvendit në sesionin më të afërt dhe, për rrjedhojë, dekreti nuk mori fuqi ligjore. Megjithatë dekreti filloi të prodhojë efekte dhe, si pasojë, me aktmarrëveshjen e datës 24.02.1994 u bë pjesëtimi vullnetar (fizik) i pasurive të sindikateve ndërmjet Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë, Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë, Sindikatës së Pavarur të Punonjësve të Naftës, Sindikatës së Pavarur të Porteve, Sindikatës së Bashkuar të Pavarur të Minatorëve, Gjeologëve dhe Pasuruesve të Shqipërisë dhe këto pasuri u regjistruan në pronësi të sindikatave në zyrat përkatëse të regjistrimit të pasurive.

Me ligjin nr.8340/1, datë 6.5.1998, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi të rregullojë pasojat e rrjedhura nga zbatimi i dekretit të sipërpërmendur “Për pasurinë e sindikatave”.

Gjykata Kushtetuese vëren se për t'i dhënë përgjigje themelit të kërkesës së paraqitur, kjo Gjykatë duhet të përcaktojë nëse ligji nr.8340/1, datë 6.5.1998 u ka njohur ose jo sindikatave pronësinë mbi këto pasuri apo sindikatat kanë qenë vetëm administruese të tyre, ashtu si edhe vetë parardhëset e tyre ish-Bashkimet Profesionale.

Gjykata Kushtetuese rithekson se parimet themelore të një shteti të së drejtës nënkuptojnë, midis të tjerave, edhe ndalimin e fuqisë prapavepruese të normave juridike. Ndalimi i veprimit prapaveprues buron nga kërkesat e sigurisë juridike, çka do të thotë se është e pamundur të gjykohen, sipas normave ligjore në fuqi, sjellje njerëzore, fakte ligjore ose marrëdhënie ligjore që kanë ndodhur para se norma të hynte në fuqi. Teoria e së drejtës pranon se fuqia prapavepruese zbatohet si përjashtim, për shembull, në ligjet penale favorizuese, në ligjet që ndërhyjnë për të rregulluar situata të paligjshme të krijuara më parë, në ligjet që interpretojnë anët e errëta ose të paqarta të një ligji të mëparshëm dhe në ndonjë rast tjetër ku paraqitet domosdoshmëria për të shmangur pasoja të rënda, negative ose të pandreqshme (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.9,*

datë 26.02.2007).

Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se Kuvendi nuk ndalohet të miratojë ligje retroaktive ose të legalizojë me efekte retroaktive praktika ose marrëdhënie ekzistuese, të cilat njihen në doktrinën kushtetuese si *ligje legalizuese*, por kjo ndërhyrje duhet të justifikohet nga interesi publik. Edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) e pranon vlefshmërinë e një legjislacioni të tillë në fushën civile dhe thekson se parimi i shtetit të së drejtës dhe nocioni i gjykimit të drejtë, të sanksionuar në nenin 6 të KEDNJ-së ndalojnë çdo ndërhyrje nga ligjvënësi – përveçse nëse justifikohet mbi “*baza detyruese të interesit publik*” – në administrimin e drejtësisë, me qëllim për të ndikuar në zgjidhjen gjyqësore të një mosmarrëveshjeje (*shih vendimin datë 28 tetor 1999, në çështjen Zielinski, Pradal, Gonzales dhe të tjerë kundër Francës*). Pra, kusht për miratimin e ligjeve, që legalizojnë praktika ekzistuese, është që ato të mos shkelin autoritetin e vendimeve të formës së prerë të gjykatave.

Gjykata vlerëson se ligji nr.8340/1, datë 6.5.1998 është ligj legalizues me efekte retroaktive, por vetëm pjesërisht, sepse megjithëse rregulloi dhe u dha fuqi prapavepruese akteve dhe veprimeve të kryera nga sindikatat për kalimin e pronësisë në bazë të dekretit të vitit 1992, si dhe marrëveshjeve të tyre për ndarjen e këtyre pasurive, nuk ka vepruar në mënyrë retroaktive mbi marrëdhëniet e rregulluara në këtë periudhë mbi bazën e ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave ose mbi ato marrëdhënie dhe praktika për të cilat gjykatat ishin shprehur përfundimisht me vendime gjyqësore të formës së prerë. Gjykata Kushtetuese, po ashtu, i gjen të justifikuara edhe arsyet e interesit publik për miratimin e ligjit nr.8340/1, datë 6.5.1998 që janë mbështetja materiale dhe financiare e shtetit në fazën fillestare të krijimit dhe ushtrimit të veprimtarisë së sindikatave, në mënyrë që ato të kryenin veprimtarinë e tyre në mënyrë të pavarur.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se dekreti nr.204 i vitit 1992, ka qenë i qartë në disponimin e tij, pra kalimin në pronësi të sindikatave të gjithë pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme që shërbente për veprimtarinë sindikale dhe edukimin profesional e sindikal të punonjësve. Megjithëse ligji nr.8340/1, datë 6.5.1998 nuk e miratoi në mënyrë të shprehur këtë dekret, ai rregulloi, përta ishte e mundur, pasojat e ardhura prej tij. Gjykata vlerëson se nga interpretimi i këtij ligji nuk rezulton të lindin dyshime për këtë fakt. Po ashtu, fakti i fitimit të pasurive nga sindikatat nuk është vënë në dyshim as faktikisht, në gjithë periudhën që ky ligj ka qenë në fuqi, pasi sindikatat janë sjellë si pronare mbi këto pasuri, në mënyrë të pashqetësuar, për një periudhë mbi 10 vjeçare.

Gjykata Kushtetuese rithekson, gjithashtu, se interpretimi i ligjeve është kompetencë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe sidomos e Gjykatës së Lartë, të cilës Kushtetuta i atribuon kompetencën për njësimin e praktikës gjyqësore. Konkretisht, përta i përket ligjit nr.8340/1, datë 6.5.1998 Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë marrë 2 vendime unifikuese, ku shprehen për efektet që pati dekreti nr.204 i vitit 1992. Në vendimin unifikues nr.85, datë 29.06.2001, Gjykata e Lartë shprehet: “*Sa herë që përplasen interesat e ish-pronarëve, që përfitojnë kthimin e ndërtesave të pandryshuara apo trojeve të pazëna, sipas dispozitave të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” me interesat e sindikatave, që i kanë fituar këto ndërtesa apo troje, sipas dekretit nr.204, datë 5.6.1992, pasojat e të cilit janë rregulluar me ligjin nr.8340/1, datë 6.5.1998, përparësi ka mbrojtja e interesave të ish-pronarëve (trashëgimtarëve të tyre). Ligji nr.8340/1 është i zbatueshëm për aq sa nuk bie në kundërshtim me dispozitat e ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve... Po t’i referohemi ligjit nr.8340/1 konstatohet se... disa dispozita përmbajnë rregullime që bëhen për herë të parë përta i përket mënyrës së administrimit nga ana e sindikatave të pasurisë së përfituar nga shteti, si dhe vendosin disa kufizime në ushtrimin e plotë të tagrave të sindikatave si pronare të pasurisë të përfituar nga shteti, (nenet 4, 6, 8)”. Ndërsa në vendimin unifikues nr.5, datë 23.03.2004, Gjykata e Lartë shprehet: “*Në pronësi të sindikatave do të mbeten ato prona përta cilat nuk ka pretendime nga ish-pronarët. Ligji nr.8340/1 nuk ka të bëjë me të drejtat e fituara nga ish-pronarët, por rregullon ato raste që prona nuk ka qenë ndonjëherë e ish-pronarit. Ligji nr.8340/1 duhet kuptuar si akt që rregullon pasojat e dekretit nr.204 për ato prona të marra nga sindikatat kur prona është e shtetit, kur nuk ka pretendime pronësie apo edhe kur prona është e individit dhe ai nuk e ka kërkuar të drejtën e tij sipas ligjit për kthimin e kompensimin e pronave”*.*

Duke iu referuar vendimeve të mësipërme të Gjykatës së Lartë, nuk vihet në dyshim fakti se me ligjin nr.8340/1, datë 6.5.1998 sindikatat kanë fituar pronësinë mbi pasuritë e administruara nga ish-bashkimet profesionale, por duke u cilësuar, gjithashtu, se kjo pronësi është fituar mbi pasuritë që nuk i janë kthyer ish-pronarëve deri në miratimin e këtij ligji ose për të cilat nuk ka pasur pretendime dhe se, në rastet kur ka konflikt midis ish-pronarëve e sindikatave, përparësi në zgjidhjen e tyre merr interpretimi dhe zbatimi i ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”. Kjo përparësi respektohet jo vetëm kur këto konflikte kanë lindur, janë gjykuar dhe vendimet kanë marrë formë të prerë para hyrjes në fuqi të ligjit nr.8340/1, datë 6.5.1998 por edhe për rastet e vërtetuara pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Gjykata Kushtetuese vëren se fakti i fitimit të pronësisë nga sindikatat konfirmohet jo vetëm nga vendimet e pushtetit gjyqësor, por edhe me akte të pushtetit qendror, ose të organeve kontrolluese të shtetit. Bazuar në VKM nr.475, datë 31.8.2000 “Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i kryqëzimit në zonën e Plepave, Durrës, të segmentit rrugor Durrës-Rrogozhinë”, rezulton se pronarë të pasurive të paluajtshme që preken, për efekt të masës së shpërblimit, janë konsideruar sindikatat, të cilave u është kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve vënia në dispozicion e dokumentacionit provues dhe konkretisht i vërtetimit të pronësisë të azhurnuar, lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Gjykata Kushtetuese vë në dukje, gjithashtu, se pas daljes së dekretit nr.204, datë 5.6.1992 si dhe të ligjit nr.8340/1, datë 6.5.1998 pasuritë janë regjistruar në pronësi të sindikatave në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, çka vërtetohet me vërtetimet përkatëse të lëshuara nga këto zyra. Gjykata Kushtetuese vë në dukje se mbajtja e regjistrimit publik të pronave të paluajtshme dhe të transferimeve të saj ka për qëllim sigurinë e të drejtave të pronës, si dhe stabilitetin e qarkullimit civil. Në vlerësimin e kësaj Gjykate, pikërisht për këtë qëllim, regjistri publik i regjistrimit të pronave të paluajtshme duhet të jetë një regjistër i sigurt dhe i besueshëm. Roli i tij është i rëndësishëm themelore, sepse nëpërmjet tij ngurtësohen të drejta subjektive. Mungesa e besueshmërisë në këtë drejtim passjell pasiguri në të drejtat e pronës (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.17, datë 23.04.2010, par.22*).

Gjykata Kushtetuese vëren, gjithashtu, se Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) ka kryer dy kontrole mbi pasuritë e sindikatave, në vitin 1998 dhe në vitin 2007.

Kontrolli i vitit 1998, i lënë si detyrë KLSH-së nga Kuvendi i Shqipërisë, objekt i të cilit ka qenë administrimi dhe evidentimi i pasurisë së paluajtshme të përfituar nga zbatimi i dekretit nr.204, datë 5.6.1992 është kryer për efekt të miratimit të ligjeve të vitit 1998. Nga ky kontroll ka rezultuar se është bërë ndarja e kësaj pasurie, hipotekimi i saj, si dhe janë kryer veprime të shitjes së kësaj pasurie, dhënies me qira dhe krijimin e shoqërive të përbashkëta dhe është vërejtur se shitja është bërë pa kriter dhe pa u mbështetur në ndonjë akt ligjor; për dhënien me qira të objekteve nuk janë mbështetur në kriter ligjore për përcaktimin e vlerës së qirasë, si dhe janë vërejtur raste të mosarkëtimit të qirasë dhe shkelje të tjera të kontratave; krijimi i shoqërive të përbashkëta nuk i ka shërbyer interesave të lëvizjes sindikaliste, por interesave të ortakëve, persona të tretë; një pjesë e mirë e objekteve janë shkatërruar. Për këto janë propozuar dhe masat përkatëse.

Raporti i dytë i KLSH-së është ai i muajit shtator 2007 dhe ka pasur për objekt kontrollin e ushtruar në Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë, në Konfederatën e Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë dhe Organizatën e Sindikatës të Pavarur të Naftës. Kontrolli është kryer për periudhën 12.05.1998 deri më 31.12.2006 dhe ka pasur për objekt zbatimin e ligjshmërisë dhe të rregullshmërisë në lidhje me pasuritë e përfituara sipas akteve ligjore përkatëse. Midis të tjerave, ky raport ka rekomanduar të merren këto masa: Të kërkohej në rrugë gjyqësore kthimi i pasurive të dhuruara në vitin 1997 sindikatave përkatëse, të shkëputura pa marrëveshje; të bëhet regjistrimi i pasurive në zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme të rretheve ku ndodhet pasuria, të cilat deri në momentin e kontrollit nuk janë të regjistruara; të ndiqet rruga ligjore “për marrjen në administrim të objekteve”, të cilat janë zënë forcërisht nga të tretët; të merren masat e nevojshme për riparimin e objekteve të prishura për t’i futur ato në efikasitet sipas ligjit.

Gjykata Kushtetuese, nisur nga masat e propozuara në këto raporte, mund të konkludojë se për kalimin e së drejtës së pronës nga shteti te sindikatat nuk ka pasur ndonjë kundërshtim nga organet shtetërore.

Kjo Gjykatë vëren, gjithashtu, se ligji nr.8340/1, datë 6.5.1998 në nenin 4 parashikon: “*Pasuria e paluajtshme e përfituar nga sindikatat në bazë të këtij ligji nuk mund të tjetërsohet deri më 31.12.2020*”. Subjektet e interesuara, bazuar edhe në këtë dispozitë, pretendojnë se sindikatat i kanë pasur në administrim pasuritë shtetërore, por nuk kanë qenë pronare të tyre, sepse u mungon një prej tagrave të pronësisë, e drejta e disponimit/tjetërsimit.

Gjykata vlerëson se, bazuar në nenin 149 të Kodit Civil, pronësia është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufijve të caktuar nga ligji, ku e drejta për të disponuar është e drejta për ta shitur ose jo sendin, për ta dhuruar, për ta lënë me testament, për ta dhënë atë si garanci reale për garantimin e detyrimeve ndaj të tjerëve etj. Fakti se ligji nr.8340/1, datë 6.5.1998 parashikon kufizime në ushtrimin e plotë të së drejtës së pronësisë nga sindikatat, duke ndaluar tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme të përfituar deri në vitin 2020, nuk është i mjaftueshëm për të arsyetuar se sindikatat nuk e kanë fituar të drejtën e pronësisë mbi këto prona.

Me këtë rast, Gjykata Kushtetuese rithekson se ligjvënësi gëzon të drejtën që të vendosë kufizime në gëzimin dhe ushtrimin e të drejtave kushtetuese, por duke respektuar për këtë qëllim kriteret e parashikuara nga neni 17 i Kushtetutës. Në rastet kur duhet të ndërhyjë për ruajtjen e një kategorie të caktuar pasurish, që i vlerëson se kanë një rëndësi të veçantë, ligjvënësi mund të përcaktojë, me anë të ligjit, rregullime me anë të të cilave të vendosë kufizime për pronarët e këtyre pasurive. Këto kufizime dhe ndalime duhet të jenë proporcionale me arritjen e qëllimit të bazuar kushtetutshmërisht dhe nuk duhet të kufizojnë të drejtën e pronësisë më shumë se sa është e nevojshme për arritjen e qëllimit ose të objektivave të rëndësishme që kërkohen të realizohen.

Gjykata Kushtetuese thekson se në rastin në shqyrtim, bazuar në faktin se pas miratimit të dekretit nr.204, datë 5.6.1992 një pjesë e pasurive u tjetërsuan te të tretët, qëllimi i ligjvënësit ka qenë mbrojtja e interesave të punonjësve, duke dashur të ruajë destinacionin fillestar të këtyre pasurive në funksion të veprimtarisë sindikaliste. Për më tepër, dhe vetë ligji nr.8340/1, datë 6.5.1998 në nenin 6, parashikon se sindikatat, në administrimin e pasurive, duhet të respektojnë objektivin e veprimtarisë sindikaliste. Duke bërë një interpretim *a contrario*, nëse ligji do t’u kishte njohur sindikatave vetëm të drejtën e administrimit të këtyre pasurive dhe jo të drejtën e pronësisë mbi këto pasuri, atëherë nuk do të ishte e nevojshme përcaktimi i një kufizimi të tillë për mostjetërsimin deri në vitin 2020, sepse e drejta për të disponuar sendet është një e drejtë ekskluzive e pronarit të sendit dhe ajo nuk mund të ushtrohet nga poseduesi jopronar, pra nuk do të kishte nevojë për një parashikim të tillë, sepse në asnjë rast sindikatat nuk mund të tjetërsonin pasuritë që nuk ishin në pronësi të tyre.

Gjykata Kushtetuese vëren se, siç u përmend edhe më sipër në këtë vendim, siguria juridike nënkupton, veç të tjerash, edhe mbrojtjen e të drejtave të fituara të personave, të cilët kanë të drejtë të presin në mënyrë të arsyeshme që të drejtat e fituara nëpërmjet akteve ligjore të vlefshme, t’u garantohen për të gjithë periudhën dhe të zbatohen realisht. Ligji duhet të ofrojë siguri dhe vijimësi, me qëllim që individët të mund të kryejnë veprimet në mënyrën e duhur. Ky parim u lejon individëve një lloj mbrojtjeje kundër ndryshimeve të menjëhershme e të pajustificueshme të rregullave.

Në rastin në shqyrtim, kërkuesit janë sjellë si pronarë mbi pasuritë e fituara me ligjin nr.8340/1, datë 6.5.1998. Ata kanë regjistruar në emrin e tyre këto pasuri në zyrat e regjistrimit të pasurive, kanë investuar në to, kanë përfituar të ardhura, kanë lidhur marrëveshje me të tretë, pra, i kanë zotëruar këto pasuri në mënyrë të pandërprerë dhe të pashqetësuar për një periudhë shumë të gjatë kohore. Në këtë mënyrë ata kanë fituar sigurinë dhe besimin se situata ligjore e favorshme për ta do të vazhdojë dhe nuk do të ketë ndryshime të tilla të menjëhershme e të pajustificueshme të rregullave që përkeqësojnë situatën e tyre ligjore.

Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se ndërhyrja në të drejtat e sindikatave, të fituara me ligjin nr.8340/1, datë 6.5.1998, nëpërmjet ligjit nr.10159, datë 15.10.2009 të kundërshtuar, cenon sigurinë juridike, si element i parimit kushtetues të shtetit të së drejtës.

2. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës së pronës private (neni 41 i Kushtetutës)

Kërkuesit kanë pretenduar, gjithashtu, se ligji nr.10159, datë 15.10.2009 u ka cenuar atyre edhe të drejtën e pronës së fituar me ligjin nr.8340/1, datë 6.5.1998.

Në përgjigje të pretendimit të mësipërm, Gjykata Kushtetuese vëren se, sipas nenit 41 të Kushtetutës, mes të tjerash, e drejta e pronës private është e garantuar (paragrafi 1), prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil (paragrafi 2), dhe se ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë (paragrafi 3).

Dispozitat e mësipërme të nenit 41 të Kushtetutës nënkuptojnë se të drejtat e pronësisë u garantohen të gjithë personave, se ligjvënësi ka detyrimin të nxjerrë ligje në mbrojtje të të drejtave të pronësisë dhe se askush nuk ka të drejtë të marrë pronën në mënyrë arbitrare dhe pa ndonjë bazë të ligjshme.

Gjykata Kushtetuese rithekson se e drejta e pronësisë, si shumica e të drejtave të tjera kushtetuese, nuk është absolute. Në bazë të Kushtetutës (neni 41/3), për interesa publikë, ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës.

Duke qenë se më sipër Gjykata Kushtetuese vlerësoi se ligji nr.8340/1, datë 6.5.1998 i ka njohur sindikatat pronare të pasurive të fituara nga zbatimi i dekretit nr.204, datë 5.6.1992 dhe se ligji i kundërshtuar i zhvesh ato nga kjo e drejtë, kjo Gjykatë duhet të vlerësojë nëse në aspektin kushtetues zhveshja nga kjo e drejtë është e lejueshme. Në këtë drejtim, duhet të mbahen parasysh kriteret e kufizimit të të drejtave dhe lirive, sipas të cilave kufizimi mund të vendoset vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe që kufizimi të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë, kufizimi të mos cenojë thelbin e lirive dhe të drejtave, si dhe në asnjë rast kufizimi nuk mund të tejkalojë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut. Përveç kësaj, meqë këtu shtrohet çështja e kufizimit të së drejtës së pronës private, duhet të mbahet parasysh edhe kriteri që përcakton neni 41/4 i Kushtetutës për shpronësimin ose kufizimin e së drejtës së pronës, përkundrajt një shpërblimi të drejtë.

Gjykata Kushtetuese thekson se në kushtet kur kjo Gjykatë në këtë vendim pranoi se me ligjin nr.8340/1, datë 6.5.1998 kërkuesit kanë fituar të drejtën e pronësisë mbi pronat përkatëse, me nxjerrjen e ligjit nr.10159, datë 15.10.2009, për shfuqizimin e ligjit nr.8340/1, përmbushet kriteri i kufizimit me ligj i së drejtës. Lidhur me kriteret e tjera të kufizimit të së drejtës, meqë subjektet e interesuara mbështeten në argumentet e tyre në faktin se sindikatat nuk e kanë fituar asnjëherë të drejtën e pronësisë dhe kanë qenë vetëm administruese të këtyre pasurive, këto subjekte nuk janë përpjekur të justifikojnë ndonjë interes publik të mundshëm për këtë ndërhyrje.

Gjykata Kushtetuese thekson, gjithashtu, se edhe në rast se do të justifikohet kjo ndërhyrje si në interes publik, neni 41 i Kushtetutës kërkon, gjithashtu, respektimin e “shpërblimit të drejtë” dhe “të drejtës së ankimit lidhur me masën e shpërblimit” në rastet e shpronësimit të pronarëve privatë. Duke qenë se ky ligj nuk njeh pronësinë e sindikatave mbi këto pasuri, ai nuk respekton kriteret e tjera të vendosura nga nenet 17 e 41 të Kushtetutës.

Për sa sipër, Gjykata Kushtetuese konkludon se ligji i kundërshtuar cenon të drejtën e pronësisë së sindikatave, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës.

3. Lidhur me pretendimin për cenimin e neneve 11, 46 dhe 50 e 118 të Kushtetutës

Kërkuesit kanë pretenduar, gjithashtu, se ligji nr.10159, datë 15.10.2009 ka shkelur parimin e lirisë së nismës ekonomike (neni 11), të drejtën e organizimit kolektiv (neni 46), të drejtën e bashkimit në organizata sindikale (neni 50), si dhe kriteret kushtetuese për nxjerrjen e akteve nënligjore (neni 118).

Lidhur me këto pretendime, Gjykata Kushtetuese vëren se argumentet e kërkuesve nuk janë ngritur në nivel kushtetues. Për rrjedhojë, kjo Gjykatë nuk mund të investohet në shqyrtimin e tyre.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “a”, dhe 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës, duke shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën ligjin nr.10159, datë 15.10.2009 “Për shfuqizimin e ligjit nr.8340/1, datë 6.5.1998 “Për rregullimin e pasojave që kanë rrjedhur nga zbatimi i dekretit nr.204, datë 5.6.1992 “Për pasurinë e sindikatave””.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Sokol Sadushi, Vitore Tusha, Sokol Berberi

Anëtarë kundër: Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo (kryetar), Petrit Plloçi, Admir Thanza

MENDIM NË PAKICË

Lidhur me ankesat/kërkesat e sindikatave drejtuar Gjykatës Kushtetuese, me objekt shfuqizimin si jokushtetues të ligjit nr.10159, datë 15.10.2009, *sa i përket pranueshmërisë për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese*, në kuptim të neneve 131/f dhe 134 të Kushtetutës, kemi mendim të ndryshëm nga shumica e kësaj gjykate, për arsyet në vijim:

Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje edhe me kërkesë të organizatave, *vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre* (nenit 134, pika 1/f dhe pika 2, i Kushtetutës) dhe kjo Gjykatë ka juridiksion të vendosë për ankesat e individëve për shkeljen e të drejtave kushtetuese, *pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave* (neni 131/f i Kushtetutës). Ndërsa, *të drejtat dhe liritë themelore... vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive...*(neni 16/2 i Kushtetutës).

Ankesat/kërkesat që paraqiten nga subjektet përkatëse, në kuptim të neneve 16/2, 131/f dhe 134 (pika 1/g dhe pika 2) të Kushtetutës, përfshihen në llojin e ankesës kushtetuese (*constitutional complaint*).

Procedura e gjykimit kushtetues të ankesës kushtetuese, që ka për objekt mbrojtjen e të drejtave apo interesave legjitime të personit, udhëhiqet nga parimi i *subsidiaritetit*, që është mishëruar në nenin 131/f të Kushtetutës. Sipas këtij parimi, ankesa kushtetuese mund të paraqitet në Gjykatën Kushtetuese vetëm *pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave dhe interesave*. Kjo do të thotë se mbrojtja e të drejtave dhe interesave legjitime të personit, në radhë të parë, është përgjegjësi e të gjitha autoriteteve publike, ku përfshihen edhe gjykatat e zakonshme. Gjykata Kushtetuese hyn në veprim vetëm pasi këto të fundit të kenë ushtruar funksionet e tyre në këtë aspekt. Pra, në sferën e mbrojtjes së të drejtave të personit, kjo Gjykatë është dizenuar të jetë subsidiare/plotësuese në raport me autoritetet e tjera publike. Për pasojë, është e përshtatshme që fillimisht të jenë këto autoritete publike ato që do të përbëjnë mekanizmin mbrojtës të të drejtave dhe interesave legjitime të personave dhe në qoftë se më pas do të paraqitet një ankesë/kërkesë kushtetuese kundër akteve të këtyre autoriteteve, kjo Gjykatë do të kishte edhe përfitimet e pikëpamjeve/opioneve kushtetuese/ligjore të gjykatave të zakonshme dhe autoriteteve të tjera publike, të cilët janë në kontakt më të drejtpërdrejtë me pretendimet e personave për shkeljen e të drejtave të tyre.

Përveç sa sipër, parimi i natyrës subsidiare të gjykimit kushtetues, synon edhe minimizimin e ndërhyrjeve të Gjykatës Kushtetuese në pushtetet e autoriteteve të tjera publike. Për pasojë, Gjykata Kushtetuese nuk është një instancë tjetër, mbi gjykatat e zakonshme, e cila mund të gjykojë vetë çështjen që kanë për gjykim gjykatat e zakonshme. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të shqyrtojë nëse vendimi i autoriteteve publike, i kundërshtuar në këtë Gjykatë, ka shkelur të drejtat apo interesat legjitime të ankuesit, të garantuara kushtetutshmërisht.

Në vështrim të konsideratave të mësipërme, mendoj se edhe ankesat/kërkesat e paraqitura nga sindikatat, në kuptim të neneve 16/2, 131/f dhe 134 (pika 1/g dhe pika 2) të Kushtetutës, përfshihen në llojin e ankesës kushtetuese.

Kështu, sindikatat ankuese/kërkuese pretendojnë se ato janë pronare të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme si dhe të vlerave monetare që i kanë patur në administrim ish-Bashkimet Profesionale të Shqipërisë dhe se këtë të drejtë pronësie e kanë fituar nëpërmjet ligjit nr.8340/1, datë 6.5.1998. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave, pretendojnë se sindikatat nuk janë pronare të pasurisë së përshkruar prej tyre, por vetëm administruese të kësaj pasurie. Në këtë mënyrë, mosmarrëveshja midis sindikatave dhe shtetit paraqitet si mosmarrëveshje pronësie, pra një mosmarrëveshje lidhur me faktin se kujt i përket e drejta subjektive e pronësisë mbi pasurinë e pretenduar. Si e tillë, kjo mosmarrëveshje është një çështje që i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme. Sipas nenit 136 të K.Pr.Civile, *në juridiksionin e gjykatave hyjnë të gjitha mosmarrëveshjet civile...* Është e qartë se mosmarrëveshja për të drejtën e pronësisë është një mosmarrëveshje civile tipike dhe për pasojë kjo mosmarrëveshje duhet të zgjidhet në gjykatat e zakonshme.

Pretendimi i kërkuesve se e drejta e tyre e pronës, në rastin në shqyrtim, është shkelur nëpërmjet ligjit nr.10159 të kundërshtuar, nuk e ndryshon çështjen në themel. Edhe në rast se ky pretendim është i vërtetë, është përsëri gjykata e zakonshme autoriteti që do ta zgjidhë këtë mosmarrëveshje pronësie. Kjo gjykatë fillimisht duhet të përcaktojë nëse sindikatat ankuese/kërkuese, me ligjin nr.8340/1, janë bërë pronare mbi pasurinë përkatëse dhe më pas do të vlerësojë nëse ligji i kundërshtuar nr.10159 i cenon ose jo ato në të drejtën e pronësisë. Në rast se vlerëson se ligji i kundërshtuar i cenon sindikatat në të drejtën e tyre të pronësisë, atëherë gjykata e zakonshme, në bazë të nenit 145/2 të Kushtetutës, duhet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, për të kërkuar një gjykim incidental lidhur me kushtetutshmërinë e ligjit përkatës.

Pa vlerësuar nëse sindikatat para daljes së ligjit nr.10159 të kundërshtuar, kanë qenë pronare të pasurisë së pretenduar, nuk mund të gjykohet lidhur me kushtetutshmërinë e këtij ligji. Vlerësimi nëse sindikatat kërkuese janë ose jo pronare nuk është një çështje e gjykimit kushtetues, por një çështje që përfshihet në juridiksionin e gjykatave të zakonshme. Vetëm në rast se këto të fundit i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, atëherë kjo Gjykatë, duke pasur në dispozicion edhe argumentet e gjykatës së zakonshme, do të përfshihet në gjykimin e kushtetutshmërisë së ligjit të kundërshtuar. Në rast se gjykata e zakonshme nuk inicion gjykimin incidental dhe në qoftë se pas shterimit të rrugës gjyqësore sindikatat ankuese/kërkuese nuk janë dakord me vendimet e gjykatave, atëherë u lind e drejta për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese.

Për këto arsye, mendojmë se çështja nuk duhet të pranohej për gjykim nga Gjykata Kushtetuese.

Anëtarë: Petrit Pllaçi, Vladimir Kristo (kryetar), Admir Thanza, Xhezair Zaganjori

UDHËZIM
Nr.423/5, datë 31.5.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.423, DATË 24.2.2010 “PËR KRITERET E PËRDORIMIT TË FONDIT TË PASHPËRNDARË TË MBROJTJES SOCIALE”

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” (të ndryshuar), ligjin nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2010” dhe në zbatim të pikës 81 të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.1, datë 21.1.2010 “Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2010”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr.423, datë 24.2.2010 “Për kriteret e përdorimit të fondit të pashpërndarë të mbrojtjes sociale” të Minisrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Pika 2 riformulohet me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“Për shpërndarjen e fondeve, në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, krijohet një komision me 7 anëtarë. Komisioni kryesohet nga Ministri dhe anëtarët e tij janë Sekretari i Përgjithshëm, Drejtori i Kabinetit të Ministrisë, Drejtori i Përgjithshëm i Politikave, Drejtori i Drejtorisë së Politikave të Shërbimeve Sociale, Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit, Analizës dhe Statistikës dhe Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.”.

2. Në pikën 6, shprehja “Sektori i Planifikimit Financiar...” zëvendësohet me shprehjen “Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit, Analizës dhe Statistikës...”.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA**
Spiro Ksera

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.3308, datë 22.4.2010, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Rexhep Ypi, i biri i Jaupit dhe i Adiles, lindur më 4.9.1920 dhe vdekur më 1.1.1941.

KËRKESË

Shtetësja Fiqirete Vuria, e bija e Demos dhe Sanijes, e datëlindjes 20.9.1957, lindur në Konispol dhe banuese në Sarandë kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, shpalljen të zhdukur të vëllait të saj, shtetasit Fatmir Osmani dhe caktimin e saj si kujdestare për administrimin e pasurisë së tij.

KËRKUESE
Fiqirete Vuria

Ndreqje gabimi

Në Fletoren Zyrtare nr.21, shtator 1995 në ligjin nr.8000, datë 21.9.1995 “Për ratifikimin e “Konventës ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë për eliminimin e tatimeve të dyfishta lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin”, në nenin 1, rreshti i dytë fjala “Çekisë” të zëvendësohet me fjalën “Greqisë”.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 1.7.2010

Doli nga shtypi më 2.7.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 36 lekë